



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER JULIAN ZHELEGU
ADRESA Njesia Bashkiake nr. 5, Rr.
Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr.
2
TEL: 0682027818

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 314

Nr. koleksioni: 66

Tirane më 13/01/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë



A2021053950007418296



A2021053950007418296



KONTRATË SHITJE KUOTE

Në Tiranë, sot më 13/01 /2021, para meje Julian Zhelegu, anëtar i Dhomës së Noterëve të Tiranës, me adrese ne rrugen “Pjeter Bogdani”, nr. 13, u paraqiten palët e kësaj Kontrate si më poshtë:

Shitësi:

Z. Klevis Lamçja, shtetas shqiptar, lindur me 07.02.1986 ne Elbasan, banues ne Elbasan, mbajtes i pasaportes me nr. BA9474326 dhe nr. personal I60207015K, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar;

(në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si “Shitësi”);

dhe

Blerësi:

Z. Hysen Dibra, shtetas shqiptar, i biri i Hidajet, lindur me 07.02.1985 ne Kavaje, Durres, banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit me nr. 032005780 dhe nr. personal I50207083T, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar,

(në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si “Blerësi”);

MEQENESE:

- A. Shitësi zotëron 50% te Kapitalit te Shoqërisë “THE CLINIC. AL” Sh.p.k, një shoqëri e themeluar e qe funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT M01323063U dhe me seli ne Tirane; (me poshte referuar “Shoqeria”);
- B. Shitesit deshiron t`i shese Bleresit dhe Bleresi deshiron te bleje nga Shitesit kuoten qe Shitesit zoteron ne kapitalin e Shoqerise, e cila perfaqeson 50% Kapitalit te Shoqërisë së lartpërmendur;
- C. Në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin Nr. 9901/2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, si dhe me vendimin bashkelidhur te Ortakut te vetem te Shoqerise, Palet deshirojne te lidhin kete Kontrate.

PER SA ME SIPER, palët bien dakord si vijon:

1. Me nenshkrimin e kesaj Kontrate Shitesit i shet Bleresit dhe Bleresi blen nga Shitesit 50% te kapitalit te Shoqerise « THE CLINIC. AL » Sh.P.K., Cmimi i shitjes i rene dakort eshte 50.000 Leke (pesedhete mije Leke) i cili eshte paguar plotesisht nga bleresi me para ne dore dhe perpara nenshkrimit te kontrates. Palet deklarojne qe nuk kane asnje pretendim lidhur me cmimin e shitjes dhe e konsiderojne ate te shlyer plotesisht.




A2021053950007418296

2. Pronësi i mbijetuar, objekt i kësaj Kontrate, kalon nga Shitësi te Blerësi menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe që nga ky moment Blerësi i lind e drejta e regjistrimit të kësaj kontrate në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
3. Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se kuota e transferuar këtu, është në pronësinë e tij të plotë dhe e lirë nga barra hipoteke apo pengje.
4. **Blerësi blen 50% (pesedhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë dhe me nënshkrimin e kësaj Kontrate do të zotërojë 50% të kapitalit të shoqërisë "THE CLINIC.AL" Sh.p.k. Me nënshkrimin e kësaj kontrate struktura e ortakëve të shoqërisë bëhet:**
 - **Z. Hysen Dibra bëhet ortak i vetëm dhe zotëruar i 100% të kapitalit.**
5. Blerësi pranon pronësinë e Kuotes duke njohur gjendjen e Shoqërisë dhe bie dakord me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lindura nga zotërimi i kuotes brenda Shoqërisë, sipas përcaktimeve të Statutit të Shoqërisë dhe ligjit shqiptar.
6. Shitësi dhe Blerësi bien dakord të zbatojnë dhe të paraqesin që në kërkesën e parë të palës tjetër dhe/ose të Shoqërisë të gjitha dokumentet e nevojshme në mënyrë që të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e transferimit të Kuotes objekt të kësaj Marrëveshjeje, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe në çdo autoritet tjetër Shqiptar sipas përcaktimeve të Ligjit Shqiptar.

Kjo Kontrate u hartua në 4 (katër) origjinale në gjuhën Shqipe. Kontrata bazohet në nenin 705 të Kodit Civil (Shqiptar) dhe në Ligjin shqiptar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Nr. 9901, datë 14.04.2008. Marrëveshja u lexua përpara palëve, u gjend e rregullt, në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe u nënshkrua rregullisht nga palët dhe u noteri vertetoi nënshkrimin e tyre në përputhje me ligjin.

PALET

SHITESI



BLERESI



NOTER

Julian Zhelegu

